

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-234/13

Prishtinë,
11 shkurt 2015

Në çështjen juridike të:

P. D. B.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetar i Kolegjit, Esma Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me aneksen kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/154/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA30014), të datës 6 qershor 2012, pas seancës së mbajtur më 11 shkurt 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e palejuar ankesa e P. Đ. B. kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/154/2012 të datës 6 qershor 2012 për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA30014, për shkak të mungesës së interesit juridik.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 20 shkurt 2007 Paraqitësi i kërkesës Đ. P. B. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) ku kërkon të drejtën pronësore dhe ri-posedim të ngastrave kadastrale ne numrat 737, 738, 739 dhe 740/1, me sipërfaqe prej 4ha 53ar 57m², fleta poseduese nr. 518, zona kadastrale Xërxë, Komuna e Rahovecit. Ai ka theksuar se ai është pronar me 1/3 të pjesës ideale të pronave të kërkuara në Xërxë, të cilat ai i ka trashëguar nga babai i tij P. S. B. pas përfundimit të procedurës trashëgimore. Ai ka theksuar se pronat ishin humbur për shkak të rrethanave që kishin ndodhur gjatë konfliktit të armatosur të viteve 1998/99 në Kosovë.
2. Për të mbështetur kërkesën e tij, Đ. P. B. (tani e tutje: Paraqitësi i kërkesës) ka dorëzuar kopjen e fletës poseduese nr. 518, komuna kadastrale Xërxë, të lëshuar më 29 gusht 2002 nga Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi i Komunës së Rahovecit, ku specifikohen ngastrat e kërkuara kadastrale me numrat 737, 738, 739 dhe 740/1.
3. Më 30 gusht 2010, Sekretaria Ekzekutive e AKP-së i ka njoftuar palët e treta potenciale lidhur me kërkesën përmes publikimit në gazetën njoftuese nr.7 dhe në buletin e Zyrës së Pronës të UNHCR-it.
4. Më 10 tetor 2007 AKP ka verifikuar pozitivisht fletën poseduese me nr. 518, të dorëzuar nga Paraqitësi i kërkesës. Sekretaria Ekzekutive ka konstatuar sipas detyrës zyrtare se të dy ngastrat ishin të regjistruara në emër të disa bashkë-pronarëve, trashëgimtarëve të P.S.B.
5. Askush nuk ishte përgjigjur ndaj kërkesës. Kërkesa ishte e pakontestuar.
6. Më herët, KKPK me Rezolutën e vet KPCC/RES/19/2010 të datës 12 maj 2010 ka shfuqizuar vendimin e KKPK-së, KPCC/D/A/3/2007 të datës 7 nëntor 2007, për arsye se kërkesa nuk është proceduar në mënyrën e duhur nga Sekretaria Ekzekutive pasi që prona e kërkuar nuk është identifikuar fizikisht dhe as nuk është notifikuar si duhet.
7. Me vendimin KPCC/D/A/154/2012 të datës 6 qershor 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) ka vendosur që Paraqitësi i kërkesës ishte pronar me 1/3 i

ngastrave të lartpërmendura kadastrale me numrat 737, 738, 739 dhe 740/1. Vendimi i KKPK-së kishte nënvizuar se “[...Kërkesat që mbulohen me këtë vendim janë të pakontestuar dhe nuk është pranuar apo siguruar asnjë provë nga Sekretaria, sipas detyrës zyrtare, që do të rrezonte prezumimin e pronësisë. Rrjedhimisht Komisioni është i kënaqur që dokumentet e dorëzuara provojnë pronësinë e Paraqitësit të kërkesës mbi pronat e kërkuara ...]”.

8. Vendimi i është dorëzuar djalit të Paraqitësit të kërkesës më 7 nëntor 2012. Më 12 gusht 2013, P. Đ. B. pas vdekjes së babait të tij (Paraqitësit të kërkesës) ka paraqitur ankesë.

Pretendimet e Palës ankuese

9. Djali i Paraqitësit të kërkesës P. Đ. B. (tani e tutje: Pala ankuese) ka apeluar tërë vendimin e KKPK-së duke theksuar se Paraqitësi i kërkesës ka qenë pronar i pronave të kërkuara. Gjithashtu, në deklaratën e tij me shkrim të bashkangjitur [(kjo është kopje identike si dhe në lëndët e AKP-së KPA30017 (GSK-KPA-A-235/2013) dhe KPA90744 (GSK-KPA-A-236/2013)] si pjesë përbërëse të ankesës, duke iu referuar pronave të paluajtshme të evidentuara në fletën poseduese nr. 518 dhe certifikatën e të drejtave të pronës së paluajtshme UL-71510033-00518, të lëshuar më 3 korrik 2012 nga Komuna e Rahovecit, ku në mes të pronave të tjera ngastrat e kërkuara me numrat 737, 738, 739 dhe 740/1 janë gjithashtu të përfshira në të, Pala ankuese pretendon se që nga viti 1932 pronar i pronave të kërkuara ka qenë gjyshi i tij P. S. B. (tani e tutje: Bartësi i të Drejtës Pronësore (BDP)). Ai shtoi se BDP ishte nën presion dhe kërcënim për të shitur pronat e kërkuara; prandaj, kontrata e shitblerjes OV.br.129/67 në mes të BDP-së dhe Komunës së Rahovecit është lidhur në mënyrë të imponuar më 14 qershor 1967. Pala ankuese gjithashtu ka theksuar se Paraqitësi i kërkesës dhe vëllezërit e tij si trashëgimtar të BDP-së kanë paraqitur padi pranë Gjykatës Komonale të Rahovecit ku kërkojnë nga gjykata anulimin e kësaj kontrateje të shitblerjes dhe shpalljen e tyre pronarë me 1/3 secili të pjesës ideale. Për më tepër, ai ka theksuar se Gjykata Komonale e Rahovecit me vendimin e saj P.br.165/97 të datës 29 shtator 1997 ka anuluar kontratën e lartpërmendur të shitblerjes dhe ka vërtetuar se Paraqitësi i kërkesës dhe vëllezërit e tij si trashëgimtar të BDP-së janë bashkëpronar me 1/3 secili të pjesës ideale të pronave të kërkuara.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

10. Ankesa e Palës ankuese hedhet poshtë si e palejuar.
11. Nga lënda rezulton se Paraqitësi i kërkesës ka kërkuar vendosjen e të drejtës së tij pronësore përmes ri-posedimit të ngastrave kontestuese. KKPK ka vendosur në të mirë të tij dhe ka vërtetuar se Paraqitësi i kërkesës është pronar me 1/3 i pjesës ideale të pronave të kërkuara dhe ka miratuar ri-posedimin (shif. nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079). Me vendimin e saj KKPK-ja ka vendosur në tërësi siç kishte kërkuar Paraqitësi i kërkesës. Sipas dispozitave të neneve 14, 15 dhe 16 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, pala ankuese mund të kërkojë nga AKP-ja ekzekutimin e vendimit.
12. Pasi që kërkesa është pranuar në tërësi, Pala ankuese i cili është trahsëgimtar i Paraqitësi të kërkesës nuk ka interes ligjor për dorëzimin e ankesës. Sipas nenit 186.3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, ankesa duhet të hidhet poshtë si e palejuar nëse personi i cili ka paraqitur ankesën nuk ka interes ligjor për të paraqitur ankesë.
13. Nga ajo që u tha më lartë, dhe në përputhje me nenin 186 paragrafi 3 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi në përputhje me nenin 13.3 nën paragrafi (b) të Rregullores së UNMIK-ut e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Këshillë ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esmat Erterzi, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it